



Emri i Biznesit: HABIB ZOGAJ B.I.  
Emri Tregtar: N.P.SH. Radio "MALISHEVA"  
Numri Unik Identifikues – 810706161  
Pronar– Habib ZOGAJ  
OSHMA "RTV MALISHEVA 2001"  
Lagjia Mirdita  
Malishevë

Ref:1908/1022/LIC/ni

### VENDIM

për licencimin e Ofruesit të Shërbimeve Mediale Adiovizuale "RTV MALISHEVA 2001"  
për transmetim përmes operatorëve të shpërndarjes – me seli në Malishevë

---

### Faktet

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audiovizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Rregullorja për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale KPM-2017/02, ka hyrë në fuqi më 25 janar 2017, ndërsa, me Kreun III të kësaj rregulloreje, KPM ka krijuar bazën ligjore për licencimin e Ofruesve të Shërbimeve Audio dhe Audiovizuale të cilët transmetojnë përmes operatorëve të shpërndarjes, e që do të kenë mundësi të prodhojnë programe përmbajtjesore dhe t'i transmetojnë ato përmes cilit do operator të shpërndarjes.
3. Më datën 22 korrik 2019, kandidati "RTV MALISHEVA 2001" ka parashtruar aplikacionin për licencë të KPM-së për të vepruar si ofrues të shërbimeve mediale audiovizuale (OSHMA) për transmetim përmes operatorit të shpërndarjes.

### Arsyetim

4. Komisioni vlerëson se, kandidati për licencë të KPM-së OSHMA “RTV MALISHEVA 2001”, në aplikacionin e tij ka paraqitur të dhënat e nevojshme për Licencë të KPM-së dhe në pajtueshmëri me Kreun III të Rregullores KPM-2017/02.
5. Komisioni vlerëson se, kandidati për licencë të KPM-së “RTV MALISHEVA 2001” ka ofruar të dhënat e mjaftueshme për vlerësim të aplikacionit. Materialet e ofruara si pjesë e aplikacionit konsiderohen të qëndrueshme sa i përket skemës programore në përgjithësi; të dhënat rreth aftësive profesionale dhe menaxheriale për të udhëhequr me ofrues të shërbimeve medilae audiovizuale, përfshirë edhe të dhënat rreth qëndrueshmërisë financiare.
6. Sipas Nenit 21, paragrafit 5 të Rregullores KPM-2017/02, kandidati për licencë të KPM-së “RTV MALISHEVA 2001” duhet të veprojë në pajtueshmëri me të gjitha rregullat dhe aktet tjera nënligjore të nxjerra nga KPM, në pajtueshmëri me Ligjin e KPM-së, si dhe me ligjet tjera të zbatueshme në Republikën e Kosovës.
7. Komisioni vlerëson se, kandidati “RTV MALISHEVA 2001” ka përmbushur kriteret kualifikuese për t’u pajisur me licencë të KPM-së për ofrues të shërbimeve mediale audiovizuale, në pajtim të plotë me Rregulloren e KPM-së KPM-2017/02.


### Vendim

8. Komisioni, në takimin e tij të mbajtur më datën 29 gusht 2019 merr vendim që, kandidatit “RTV MALISHEVA 2001” me seli në Malishevë, t’i lëshoj licencën për të vepruar si Ofrues i Shërbimeve Mediale Audiovizuale me transmetim përmes operatorëve të shpërndarjes, në Republikën e Kosovës.
9. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti hyn në fuqi që nga data e nënshkrimit.

  
Muja FERATI

Kryetar

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE

  
29.08.2019

datë